

E DREJTA PËR INFORMIM

28 SHTATOR

DITA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTËS PËR INFORMIM



28 Shtatori është Dita e të Drejtës për Informim, e njohur ndërkombëtarisht si Dita e Aksesit Universal në Informacion – International Day of Universal Access to Information (IDUAI). Promovimi dhe nxitja e kulturës së transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike është një nga elementet kyç të mirëqeverisjes dhe funksionimit të demokracisë.

Prej vitit 2019 kjo datë është njohur zyrtarisht nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ndërsa UNESCO e kremton atë prej vitit 2015.

Me këtë rast, anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), pjesë e të cilit prej vitit 2021 është edhe Komisioneri shqiptar, kanë përgatitur një video-mesazh ndërgjegjësues të cilin e gjeni në kanalën youtube të Zyrës së Komisionerit. Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim u vendos si e tillë në përfundim të Konferencës “Për lirinë e informimit”, e zhvilluar në Sofje të Bullgarisë, në 26-28 shtator 2002, me pjesëmarrjen edhe të Shqipërisë. Me këtë rast, Zyra e Komisionerit zhvilloi një trajnim me stafin e Bashkisë Tiranë. (Për më shumë lexoni në faqen nr. 4).

Vendim Nr. 39 - Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

Vendim Nr. 40 - Bashkia Tiranë/Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit

Vendim Nr. 42 - Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Vendim Nr. 43 - Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Vendim Nr. 44 - Radio Televizioni Shqiptar/Këshilli Drejtues

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit shtator 2023.



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit shtator 2023, ka dhënë 5 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Me vendimin nr. 43, datë 25.09.2023, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (Autoriteti Publik), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës ku objekt i kërkesës është vënia në dispozicion e dokumentacionit në lidhje me listën e subjekteve të kallëzuara në Prokurori nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për vitet 2015 - 2022 dhe periudhën 1 Janar 2023 - Korrik 2023.

Koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, i ka kthyer përgjigje ankuesit duke i vënë në dispozicion informacion lidhur me numrin total të kallëzimeve në prokurori për periudhën 1 Janar 2015 - 31 Korrik 2023, listën e subjekteve të kallëzuar me iniciale, llojin e objektit të aktivitetit, qarkun ku ushtrojnë aktivitet këto subjekte si dhe numrin e kallëzimeve të grupuar për secilin vit objekt kërkimi. Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi pretendon se, nuk i është vënë në dispozicion lista me emrat e plotë të subjekteve të kallëzuara në prokurori dhe ndodhur në këto kushte, i është drejtuar Komisionerit.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, Zyra e Komisionerit vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”). Pas shqyrtimit të ankesës, Komisioneri në vendimarrjen e tij arsyetoi si më poshtë:

Në argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik se kufizimi i dhënies së informacionit është bërë për të garantuar një jetë private duke mbajtur

parasysh që pjesa më e madhe e subjekteve tregtare kanë statusin e tregtarit sipas nenit 2/1 dhe 4 të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar si dhe nisur nga natyra sensitive e të dhënave sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, lista me iniciale është bërë duke synuar kufizimin e këqpërdorimit ndaj subjekteve me qëllim moscenimin e aktivitetit tregtar . Komisioneri vlerëson se, këto pretendime nuk qëndrojnë pasi konstatohet se, Autoriteti Publik në argumentin e parashtruar për mos dhënie të informacionit, nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, propocionale, si dhe dëmin që mund t’u shkaktojë kompanive si pasojë e dhënies së informacionit të kërkuar.

Po ashtu bazuar, në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, parashikohet: “Të dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social. Në këtë kuadër, emrat e subjekteve tregtare të regjistruar si person fizik ose juridik në bazë të legjislacionit përkatës tregtar, nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje nga ky ligj.

Ndërkohë, në nenin 18 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, është përcaktuar qartë kufiri i sekretit tregtar, i cili përfshin vetëm informacionin e brendshëm. Megjithatë, në pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji parashikohet se: “2. Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik”. (vazhdon fq. nr 3)

Nisur nga kjo, lidhur me pretendimin e Autoritetit Publik se dhënia e listës së subjekteve me iniciale, bëhet e tillë pasi nëpërmjet një vendimi gjyqësor të formës së prerë është ngarkuar nga Gjykata Administrative e Apelit me detyrimin për dëmshpërblim material e moral për prishje të imazhit ndaj subjektit tregtar, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron. Vendimi i referuar nuk është vendim unifikues, i cili mund të shërbejë si precedent për çështjen objekt shqyrtimi. Për më tepër, që informacioni i kërkuar lidhet me sigurinë ushqimore dhe si rrjedhojë paraqet interes publik.

Sa i përket pretendimit të Autoritetit Publik se bazuar në Ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, përcaktohen “Parimet e përgjithshme të analizës së riskut dhe mbrojtjes së interesave të konsumatorit”, respektivisht në nenet 4-9 të tij, lidhur me zbatimin e parimit të transparencës dhe mbrojtjes së interesave të konsumatorit, AKU merr masa dhe informon publikun mbi rrezikun e produkteve ushqimore dhe natyrën e rrezikut, Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nuk qëndron, pasi procedura e sipërcituar është një detyrim ligjor, i cili buron nga ligji organik dhe si rrjedhojë bën pjesë në kategoritë e informacionit që konsiderohet dhe bëhet publik pa kërkesë.


Sqarojmë se LDI, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) informacioni që bëhet publik pa kërkesë dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar. Në kategorinë e parë, përfshihen ato kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vihen në dispozicion nga Autoriteti Publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti, ndërsa rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, që përfshin ato informacione për njohjen e të cilave është e nevojshme të paraqitet një kërkesë për informim pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI, detyrim të cilin Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur.

Lidhur me pretendimin se përhapja dhe vënia në dispozicion e informacionit për rastet e referuara në prokurori kufizohet në përputhje me shkronjën b) të pikës 2 të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilën parashikohet se: “E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale; {...}”, Komisioneri vlerëson se, gjatë hetimit administrativ, Autoriteti Publik nuk provoi se kush ishin rastet e referuara në prokurori të cilat ishin në fazën e hetimeve, të pezulluara, të pushuara apo të dërguara për gjykim, në mënyrë të tillë që të mbështeste qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese, të përcaktuar në këtë kontratë, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me LDI.

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

TAKIM ME BASHKINË TIRANË ME RASTIN E 28 SHTATORIT - DITËS NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTËN PËR INFORMIM



Në kuadër të Ditës për të Drejtën e Informimit, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, organizuan një aktivitet për të nxitur transparencën, llogaridhënien, përgjegjshmërinë dhe mirëqeverisjen. Në këtë takim ndërgjegjësues ishin të pranishëm nëpunës të njësisë më të madhe të vetëqeverisjes vendore në vend.

Për Zyrën e Komisionerit Bashkia Tiranë është një partner korrekt dhe i përkushtuar në zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit, ashtu si edhe në kultivimin e kulturës së transparencës dhe mirëqeverisjes. “Bashkia Tiranë mban një peshë shumë të madhe në dhënien e informacionit, po ashtu edhe në përcaktimin e standardeve të shërbimit për qytetarët. Zyra e Komisionerit është partner i çdo autoriteti publik, i çdo aktori të shoqërisë civile apo medias dhe patjetër, një derë e hapur për çdo qytetar, pasi kjo është një e drejtë dhe liri themelore e sanksionuar në Kushtetutën e Shqipërisë” – theksoi Komisioneri, z. Besnik Dervishi, në fjalën e tij përshëndetëse.

Kryetari i Bashkisë, z. Erion Veliaj e vlerësoi si një lajm shumë të mirë faktin që Tirana do të jetë mikpritëse e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) në 2024, duke e kthyer kryeqytetin në qendër graviteti globale. “Transparenca nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një mision dhe Bashkia ka angazhuar shumë resurse për këtë qëllim. E drejta për informim nuk është një privilegj, por një domosdoshmëri për një shoqëri të lirë, ajo është një e drejtë dhe liri themelore” – tha ndër të tjera ai.

Në vijim të aktivitetit, për të pranishmit u prezantuan pikat kryesore të legjislacionit për të drejtën e informimit si dhe raste nga praktika e veprimtarisë së autoriteteve publike dhe Zyrës së Komisionerit. Një nga çështjet kryesore të trajtuara ishte ajo e transparencës proaktive (Programi i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve), në funksion të përditësimit të vazhdueshëm të informacionit në shërbim të qytetarëve. Njëkohësisht, u theksua se forcimi dhe konsolidimi i rolit të koordinatorit brenda strukturës institucionale, shërben për më shumë përgjegjshmëri në ushtrimin e funksioneve publike.

UNESCO DHE UNIVERSITETI I OKSFORDIT ORGANIZOJNË TAKIM NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Me temë “Rëndësia e hapësirës online për aksesin në informacion”, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) dhe Universiteti i Oksfordit në Britani, zhvilluan konferencën me rastin e 28 Shtatorit – Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit.



Në këtë aktivitet mori pjesë për të herë të parë edhe Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Po ashtu të pranishëm ishin edhe përfaqësues të institucioneve anëtare të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), përfaqësues nga shoqëria civile dhe aktorë të tjerë që kontribuojnë në fushën e qasjes/aksesit në informacionin me karakter publik në nivel ndërkombëtar.



Në fokus të diskutimeve ishte shkëmbimi i ideve për fuqizimin e standardeve për ushtrimin e kësaj të drejte, duke marrë në konsideratë zhvillimin e teknologjisë dhe hapësirës digjitale. Në këtë frymë, konferenca ishte e ndarë në tre panele të ndryshme, ku u diskutuan temat: “Lidhja me internetin si një mundësues i aftësisë për të ushtruar të drejtat, me një fokus të veçantë në aksesin në informacion”; “Teknologjia për demokracinë dhe zhvillimi i qendrueshëm”, si dhe “Perspektiva e gjyqësorit dhe rregullatorëve të informimit për aksesin dhe lidhjen në internet”.

UNESCO luan një rol qendror në promovimin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtës për Informim që prej vitit 2015, kur kjo organizatë e njohu zyrtarisht këtë datë. 28 Shtatori ka për qëllim promovimin dhe avokimin e aksesit në informacion, si një e drejtë themelore e njeriut dhe një gur themeli i qeverisjes së mirë dhe demokracisë.

Zbatimi i legjislacionit për të drejtën e informimit dhe ai për mbrojtjen e të dhënave personale, takime në Malësinë e Madhe




Në kuadër të bashkëpunimit mes Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Prezencës në Shqipëri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), u zhvillua në Bashkinë Malësi e Madhe takim njohës për zbatimin e legjislacionit në të dy këto fusha. Në aktivitetin ndërgjegjësues me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të autoriteteve publike të kësaj zone, ishin të pranishëm Komisioneri, z. Besnik Dervishi, zyrtari i lartë ligjor i OSBE, z. Mauro Puzzo dhe Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, z. Tonin Marinaj. Në takim u theksua rëndësia e përbushjes së detyrimeve ligjore në të dy fushatat e përgjegjësive të Zyrës së Komisionerit, të cilat ndikojnë në rritjen e transparencës dhe mirëqeverisjes e nga ana tjetër, forcojnë përgjegjshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve për qytetarët.

Në këtë aktivitet u trajtuan elemente të ndryshëm të kuadrit rregullator si në fushën e të drejtës për informim dhe në atë për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe mbi veprimtarinë monitoruese e mbikëqyrëse të Zyrës së Komisionerit. Gjithashtu, një vëmendje e posaçme iu kushtua risive që do të sjellë legjislacioni i ardhshëm kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale, që transponon tërësisht Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian (GDPR), ashtu si dhe ndryshimet dhe përmirësimet në ligjin “Për të drejtën e informimit”.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDIMP](https://www.youtube.com/KomisioneriKDIMP)